# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-448687**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vendimi për liderët e UÇK-së, reagon politika/ Rama: Marre! Bardhi: Ditë e rëndë për kombin shqiptar \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/16/vendimi-per-lideret-e-uck-se-reagon-politika-shqiptare-rama-marre-bardhi-dite-e-rende-per-kombin-shqiptar/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 10:33:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:01:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cc5f2d8f4cd1c4a398510b0bd2b835ddeca9a565e1afa88bc51286f3ee395fa5` |
| TEKSTI | `fd9daa23c9ec04fdd70c7f9d2b573428085707f8428ecfb26b9cadf9868e1cff` |
| PAMJA | `0c6f932826e4e639cd70e07a90bb6ffcafb74f219a97acaa4385ec76bd91e4da` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `71a5ee19735c7873bac904498106b4bb37ba0c6ca651f5631e5c4d9642272d0e` |
| E MËPARSHMJA | `958720c266a3a7928b46b0f149c560d43e84c975ae17e763dcfc593f89f5b86b` |
| RRËNJA MERKLE | `9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/71a5ee19735c7873bac904498106b4bb37ba0c6ca651f5631e5c4d9642272d0e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Vendimi për liderët e UÇK-së, reagon politika/ Rama: Marre! Bardhi: Ditë e rëndë për kombin shqiptar

13:01 : 16/09/2026 në **AKTUALITET, POLITIKE**



Gjykata në Hagë ka shpallur fajtorë 4 krerët e UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, dhe i kanë dënuar në total me 81 vite burgim.

Trupi gjykues konstatoi se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë penalisht përgjegjës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi janë dënuar secili me nga 25 vite burgim, Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13.

Pas këtij vendimi kanë ardhur edhe reagimet e para të politikës shqiptare. Edi Rama ka zgjedhur ta komentojë vetëm me një fjalë vendimin e dhënë: *Marrë!*

Ndërkohë kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, e ka cilësuar vendimin si "të pabesueshëm" dhe "të papranueshëm", duke e përshkruar këtë ditë si "të rëndë për kombin shqiptar" dhe, sipas tij, edhe më të rëndë për njerëzimin dhe botën demokratike.

**Lexo edhe:**

Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri

Jorida Tabaku reagon pas vendimit të Hagës: Një ditë e rëndë për çdo shqiptar

*"E pabesueshme, e Papranueshme*

*Ditë e rëndë për kombin shqiptar, por akoma më e rëndë për njerëzimin dhe botën demokratike. Shqiptarët janë edhe më të fortë pas kësaj PADREJTËSIE DHE TURPI TË NJERËZIMIT!*

*Askush nuk mund ta bëjë pis luftën e drejtë për LIRINË E KOSOVËS. Përjetësisht me UÇK-në!* – shkruan Bardhi.

Një reagim ka ardhur edhe nga Ministri i Brendshëm, Ervin Demo. Ai shprehet se historia e luftës për çlirimin e Kosovës nuk mund të ndryshohet apo të fshihet.

TË GJITHA


Kush është Charles Smith, amerikani që dënoi me 81 vjet burgim katërshen e UÇK-së
15:31 : 16/09/2026


Vendimi i Speciales/ Hamza: Një ditë turpi për drejtësinë ndërkombëtare
15:12 : 16/09/2026


Taksistët protestë para Bashkisë së Tiranës: Të mos jepen licenca pa limit
15:08 : 16/09/2026



Këto 3 shenja do të lënë pas vështirësitë
15:01 : 16/09/2026


BE propozon mekanizëm emergjent për fluksin e emigrantëve
14:50 : 16/09/2026


Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri
14:32 : 16/09/2026


Tiranë/ Zbulohet një lokal i përshtatur për shitje droge dhe lojëra fati, arrestohet pronari
14:32 : 16/09/2026

*“Liria e Kosovës nuk gjykohet. Nuk dënohet. Nuk rishkruhet. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë emra të UÇK-së dhe figura të luftës për lirinë e Kosovës.*

*Kosova e di kush ishte agresori dhe kush luftoi për çlirimin e saj. Historia nuk rishkruhet. Liria e Kosovës nuk zhbëhet.”* shkruan ai.

Ndërkohë Presidenti Bajram Begaj, shprehu “trishtim të thellë” për vendimin e sotëm, ndërsa vlerësoi vendosmërinë për apelimin e aktgjykimit.

*“Trishtim i thellë për vendimin e sotëm.*

*Vendosmëria për të apeluar vendimin është shenjë e fortë integriteti dhe qëndrueshmërie. Për shqiptarët, askush dhe asgjë nuk njollos UÇK-në!*

*Liria ka emër”*, shkruan Begaj.

Ish-deputeti i PD, Ervin Salianji shprehet se lufta çlirimtare e Kosovës ishte e drejtë dhe se vendimi i një gjykate nuk mund të ndryshojë historinë apo të zhbëjë sakrificat e shqiptarëve të Kosovës.

*“Lufta çlirimtare ishte e drejtë. Asnjë gjykim nuk mund të fshijë historinë dhe të zhbëjë sakrificën e Kosovës për liri.*

*Sot, më shumë se kurrë, shqiptarët janë bashkë. Nga Kosova në Shqipëri, nga Presheva në Tetovë e në çdo cep ku rreh zemër shqiptare, zëri është një: lufta çlirimtare ishte e drejtë! Shqiptarët, me dinjitet dhe kokën lart”*, shprehet Salianji.

Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu,  i ka cilësuar dënimet si “goditje të rëndë” për familjet e tyre dhe si një moment të rëndë për Kosovën dhe shqiptarët.

“Aktgjykimi i sotëm dhe dënimet e shqiptuara ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit janë një goditje e rëndë për familjet e tyre, një lajm thellësisht tronditës për Republikën e Kosovës dhe një çast i rëndë për kombin shqiptar kudo që jeton”, ka shkruar Haxhiu ndër të tjera.

**Etiketa:** Edi Rama | Hashim Thaçi | uck

**Lajme të lidhura**



**Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri**

14:32 : 16/09/2026



**Jorida Tabaku reagon pas vendimit të Hagës: Një ditë e rëndë për çdo shqiptar**

14:20 : 16/09/2026



**Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit**

13:58 : 16/09/2026



**Dënimi i krerëve të UÇK, Berisha: I padrejtë dhe i pamerituar!**

13:55 : 16/09/2026



**Nga Guardian te Reuters, çfarë shkruajnë mediat e huaja për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së**

13:28 : 16/09/2026



**“Serbia vrau mbi 13 mijë persona”, Osmani: UÇK ishte betimi i përgjakur i njerëzve të shtypur që donin çlirimin**

13:10 : 16/09/2026

BOLD NEWS

**RRETH NESH**

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë

**NA NDIQ**




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.